



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VIII
Sesioni pranveror
Kryesia e Kuvendit
P-038

Prishtinë, më 30 maj, ora 11:00 dhe 6 qershor 2022, ora 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 30 MAJ DHE 6 QERSHOR
2022

E hënë, më 30 maj 2022, ora 11:00

Në mbledhje morën pjesë: Glauk Konjufca, kryetar i Kuvendit; Slavko Simiq dhe Bekim Arifi, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare në mbledhje morën pjesë: Adnan Rrustemi, Abelard Tahiri, Arben Gashi, Besnik Tahiri dhe Enis Kervan.

Në mbledhje ishin të pranishëm: Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, Ismet Krasniqi, si dhe stafi përgjegjës në mbështetje të Kryesisë së Kuvendit.

Mbledhjen e drejtoi Glauk Konjufca, kryetar i Kuvendit.

Kryetari konstatoi se nuk ka kuorum për mbajtjen e mbledhjes, ndërsa propozoi që të hënë, më 6 qershor 2022, të mbahet vazhdimi i dy (2) seancave plenare me pikat e papërfunduara.

Diskutimi i plotë i kryetarit është dhënë në transkript.

Pastaj, kryetari vendosi që vazhdimi i dy (2) seancave plenare me pikat e papërfunduara të mbahet të hënën, më 6 qershor 2022, me fillim në orën 11:00, me këtë:

Rend dite

I. Pikat e papërfunduara nga seanca plenare, e filluar më 5, 11 dhe 13 maj 2022:

5. *Votimi në parim i Projektligjit nr. 08/L-142 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që përcaktojnë shumën e beneficionit në lartësi të pagës minimale, procedurat e caktimit të pagës minimale dhe shkallët tatimore në të ardhurat personale vjetore,*
6. *Votimi në parim i Projektligjit nr. 08/L-143 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 08/L-066 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022,*
7. *Emërimi i Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës,*
8. *Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për një (1) anëtar të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës nga komuniteti shqiptar.*

II. Pikat e papërfunduara nga seanca plenare, e filluar më 26 maj 2022:

4. *Votimi në lexim të dytë i Projektligjit nr. 08/L-033 për provimin e jurisprudencës,*
5. *Votimi në lexim të dytë i Projektligjit nr.08/L-052 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-010 për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës,*
6. *Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-070 për pijet e forta alkoolike,*
7. *Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-010 për krijimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit hapësinor në Republikën e Kosovës,*
8. *Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-027 për mbeturinat nga industritë nxjerrëse të mineraleve,*
9. *Zgjedhja e pesë (5) zëvendësve të Avokatit të Popullit,*
10. *Zgjedhja e një (1) anëtarit të Komisionit të Pavarur për Media.*

Ndërsa, kryetari nuk vendosi për vazhdimin e seancave tjera plenare me pikat e papërfunduara.

Më pas, kryetari i GP të PDK-së, Abelard Tahiri, në cilësinë e propozuesit, e tërhoqi debatin parlamentar për punën e Qeverisë së Republikës së Kosovës në vitin e parë të mandatit të saj, i cili ishte në rendin e ditës të seancës plenare me pikat e papërfunduara, e filluar më 5, 11 dhe 13 maj 2022. Diskutimi i plotë i të cilit është dhënë në transkript.

Në fund, kryetari i njoftoi të pranishmit se kjo mbledhje do të mbahet të hënën, më 6 qershor 2022, në orën 10:00.

Kryetari në mungesë të kuorumit e ndërpreu mbledhjen e Kryesisë në orën 11:35 minuta.

* * *

E hënë, më 6 qershor 2022, ora 10:00

Vazhdimi i mbledhjes së Kryesisë së Kuvendit, e filluar më 30 maj 2022

Në mbledhje morën pjesë: Glauk Konjufca, kryetar i Kuvendit; Enver Hoxhaj, Kujtim Shala, Slavko Simiq dhe Bekim Arifi, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare në mbledhje morën pjesë: Mimoza Kusari-Lila, Abelard Tahiri, Arben Gashi, Besnik Tahiri dhe Enis Kervan.

Në mbledhje ishin të pranishëm: Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, Ismet Krasniqi, si dhe stafi përgjegjës në mbështetje të Kryesisë së Kuvendit.

Mbledhjen e drejtoi Glauk Konjufca, kryetar i Kuvendit.

Me propozim të kryetarit, Kryesia e Kuvendit e plotësoi rendin e ditës me pikën për seancën e re plenare: Përzgjedhja e kandidatit për një (1) anëtar joekzekutiv të Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës.

Pastaj, Kryesia i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mëparshme të Kryesisë së Kuvendit,
2. Përgatitjet për seancë të re plenare,
3. Shqyrtimi i propozimeve dhe i kërkesave.

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mëparshme të Kryesisë së Kuvendit, të mbajtura më 29 prill, 5, 16 dhe 23 maj 2022

Kryesia i miratoi pa vërejtje procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura, më 29 prill, 5, 16 dhe 23 maj 2022.

2. Përgatitjet për seancë plenare të re të radhës

Kryesia, pasi i shqyrtoi përgatitjet e nevojshme dhe pas diskutimeve, vendosi që seanca plenare e radhës e Kuvendit të Republikës së Kosovës të mbahet të enjten, më 16 qershor 2022, në orën 10:00, me këtë:

Rend dite

1. Deklarimet jashtë rendit të ditës,
2. Pyetjet parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit nga seanca plenare e mëparshme,
4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-115 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-021 për akcizën në produktet e duhanit,

5. *Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-136 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës,*
6. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr.08/L-134 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 04/L-101 për fondet pensionale të Kosovës, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 04/L-115, me Ligjin 04/L-168 dhe Ligjin nr. 05/L-116,*
7. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-137 për Pyjet,*
8. *Miratimi i buxhetit të Komisionit Hetimor Parlamentar lidhur me procesin e vendimmarrjes në sektorin e energjisë për periudhën 2006-2022, në nivelin legjislativ, ekzekutiv, rregullator dhe në ndërmarrje publike,*
9. *Shqyrtimi i kërkesës së Komisionit Hetimor Parlamentar lidhur me procesin e vendimmarrjes në sektorin e energjisë për periudhën 2006-2022, në nivelin legjislativ, ekzekutiv, rregullator dhe në ndërmarrje publike, për zgjatjen e mandatit,*
10. *Propozimet e grupeve parlamentare të LVV-së dhe PDK-së për zëvendësimin e anëtarëve në komisionet hetimore parlamentare,*
11. *Emërimi i kryetarit dhe katër (4) anëtarëve të Bordit të Organin Shqyrtues të Prokurimit,*
12. *Përzgjedhja e kandidatit për një (1) anëtar joekzekutiv të Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës,*
13. *Formimi i Komisionit ad hoc për reformën zgjedhore në Kosovë.*

Në vazhdim, kryetari i GP të PDK-së, Abelard Tahiri, propozoi që shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-134 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 04/L-101 për fondet pensionale të Kosovës, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 04/L-115, me Ligjin 04/L-168 dhe Ligjin nr. 05/L-116, të jetë pikë nr. 4 e rendit të ditës të seancës plenare të caktuar për datë 16 qershor 2022. Diskutimi i plotë i të cilit është dhënë në transkript.

Pastaj, Kryesia vendosi që rendi i ditës i seancës plenare të caktuar për datën 16 qershor 2022 do të plotësohet edhe me pika të reja, për të cilat do të vendosë Kryesia e Kuvendit në mbledhjen, e cila do të mbahet më 13 qershor 2022.

* * *

Në vazhdim, kryetari i GP të PDK-së, Abelard Tahiri, e shtroi çështjen e votimit në lexim të dytë të Projektligjit nr. 08/L-052 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.05/L-010 për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, nga pikat e rendit të ditës të vazhdimit të seancave plenare, e caktuar që të mbahet më 6 qershor 2022, në orën 11:00.

Ai kërkoi që ky projektligj të mos votohet në seancën plenare që i vazhdon punimet më 6 qershor 2022 dhe që ta shqyrtojë edhe një herë Komisioni Funkcional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit. Diskutimi i plotë i kryetarit të GP të PDK-së, Abelard Tahiri, është dhënë në transkript.

Në lidhje me çështjen e lartshënuar, të shtruar nga z. Tahiri, diskutoi kryetari i GP të AAK-së, Besnik Tahiri, diskutimi i të cilit është dhënë në transkript.

3. Shqyrtimi i propozimeve dhe i kërkesave

1. Propozimi për formimin Komisionit ad hoc për përmirësimin dhe forcimin e procesit zgjedhor

Kryesia e radhiti formimin Komisionit ad hoc për reformën zgjedhore në Kosovë në rendin e ditës të seancës plenare, e cila do të mbahet më 16 qershor 2022, në orën 10:00.

Kryesia, po ashtu nxori edhe këtë:

P Ë R F U N D I M

1. Kërkohe nga grupet parlamentare të Kuvendit që deri në mbajtjen e seancës plenare, më 16. 6. 2022, t'i propozojnë deputetët për kryetar, zëvendëskryetar të parë dhe zëvendëskryetar të dytë, si dhe për anëtarë të Komisionit ad hoc për reformën zgjedhore në Kosovë.
2. Përbërja e Komisionit ad hoc duhet të jetë sipas Deklaratës së Përbashkët të kryetarëve të grupeve parlamentare në lidhje me forcimin e procesit zgjedhor në Kosovë, nga takimi i mbajtur më 13 prill 2022, si në vijim:
 - GP i LVV-së e propozon zëvendëskryetarin e parë e parë dhe tre (3) anëtarë,
 - GP i PDK-së e propozon kryetarin dhe një (1) anëtar,
 - GP i LDK-së i propozon dy (2) anëtarë,
 - GP i Listës serbe e propozon një (1) anëtar,
 - GP i AAK-së e propozon një (1) anëtar, dhe
 - GP Multietnik e propozon zëvendëskryetarin e dytë.
3. Sipas pikës së parë të Deklaratës së Përbashkët të kryetarëve të grupeve parlamentare në lidhje me forcimin e procesit zgjedhor në Kosovë, në përbërjen e Komisionit ad hoc (*nga pika dy (2) e këtij përfundimi*), do të jenë kryetarët e grupeve parlamentare dhe për aq sa është e mundur të ketë edhe përfaqësim gjinor.

2. Procedimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-131 për skemat pensionale të financuara nga Shteti

Kryesia, në lidhje me procedimin e nismës legislative të lartshënuar, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Kërkohe nga Qeveria e Republikës së Kosovës që ta paraqesë mendim lidhur me Nismën legislative të shtatë (7) deputetëve të Kuvendit të Kosovës: “Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-131 për skemat pensionale të financuara nga Shteti”, si dhe ta përgatisë Deklaratën e ndikimit buxhetor dhe Deklaratën për përafrim me legjislacionin e BE-së të këtij projektligji në afatin prej një (1) muaji nga dita e pranimit.

3. Kërkesa e Komisionit Hetimor Parlamentar lidhur me procesin e vendimmarrjes në sektorin e energjisë për periudhën 2006-2022, në nivelin legjislativ, ekzekutiv, rregullator dhe në ndërmarrje publike, për zgjatjen e mandatit

Kryesia e radhiti kërkesën e Komisionit Hetimor Parlamentar të lartshënuar në rendin e ditës të seancës plenare, e cila do të mbahet më 16 qershor 2022, në orën 10:00.

4. Kërkesa e Komisionit Hetimor Parlamentar lidhur me procesin e vendimmarrjes në sektorin e energjisë për periudhën 2006-2022, në nivelin legjislativ, ekzekutiv, rregullator dhe në ndërmarrje publike, për zëvendësimin e anëtarit të këtij komisioni

Kryetari i njoftoi të pranishmit se Komisioni Hetimor Parlamentar i lartshënuar ka parashtruar kërkesë për zëvendësimin e anëtarit - deputetit Haki Abazi, ngase deputeti Abazi me vullnet ka njoftuar se nuk dëshiron të jetë pjesë e këtij komisioni.

Po ashtu, edhe kryetari i GP të PDK-së propozoi që të procedohet edhe një propozim i këtij Grupi Parlamentar për zëvendësimin e anëtarit në Komisionin Hetimor Parlamentar lidhur me menaxhimin e krizës energjetike nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

Pastaj, Kryesia i radhiti propozimet e grupeve parlamentare të LVV-së dhe PDK-së për zëvendësimin e anëtarëve në komisionet hetimore parlamentare në rendin e ditës të seancës plenare, e cila do të mbahet më 16 qershor 2022, në orën 10:00.

5. Mocioni i Grupit Parlamentar të LDK-së për shkarkimin e Bordit të Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE-së)

Kryetari i njoftoi të pranishmit se kryetari i GP të LDK-së, Arben Gashi, ka parashtruar Mocion për shkarkimin e Bordit të Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE-së), duk iu referuar nenit 40 paragrafi 1 të Rregullores së Kuvendit, ndërsa ai shtoi se mocioni nuk është parashtruar në pajtim me nenin 15.8 të Rregullores së Kuvendit (nuk e ka mbështetjen e gjashtë ose më shumë deputetëve të Kuvendit) dhe nuk është në pajtim me dispozitat e Ligjit nr. 05/L-084 për Rregullatorin e Energjisë.

Diskutimi i plotë i kryetarit është dhënë në transkript.

Më pas, kryetari i GP të LDK-së, Arben Gashi, deklaroi se do ta riprocedojnë mocionin me nënshkrimet e gjashtë deputetëve, sipas nenit 15.8 të Rregullores së Kuvendit, diskutimi i të cilit është dhënë në transkript.

Pastaj, kryetari i Kuvendit, Glauk Konjufca, deklaroi se mocioni fillimisht do t'i dërgohet Komisionit Funkcional, pastaj Komisioni ia paraqet raportin me rekomandime seancës plenare.

6. Kërkesa për lejimin e udhëtimit zyrtar në Maqedoni të Veriut

Kryesia, në lidhje me kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës: Driton Hyseni, Arbëreshë Kryeziu-Hyseni dhe Agon Batusha, u miratohen shpenzimet e udhëtimit dhe mëditjet në lidhje me udhëtimin zyrtar të realizuar në Maqedoni të Veriut, prej 3 deri më 5 qershor 2022.

7. Kërkesa për lejimin e udhëtimit zyrtar në Mbretërinë e Bashkuar

Kryesia, në lidhje me kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

1. Deputetit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Avdullah Hoti, i lejohet udhëtimi zyrtar në Londër (Mbretëri të Bashkuar), prej 23 deri më 25 qershor 2022.
2. Të gjitha shpenzimet e udhëtimit, të akomodimit dhe mëditjet për të lartshënuarin në pikën një (1) të këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës, sipas kërkesës së bashkangjitur me nr. 08/1986/Do-863, datë 25. 5. 2022.

* * *

Po ashtu, Kryesia, në lidhje me kushtet dhe kriteret për udhëtimet zyrtare të deputetëve të Kuvendit të Kosovës, me propozim të kryetarit të Kuvendit, nxori edhe këtë:

P Ë R F U N D I M

Kërkohej nga Administrata e Kuvendi të Republikës së Kosovës që ta hartojë një Propozim-Rregullore për caktimin e kushteve, kriterëve dhe mënyrën e lejimit të udhëtimeve zyrtare jashtë vendit të deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe stafit të Administratës së Kuvendit dhe t'ia paraqesë Kryesisë së Kuvendit për miratim.

* * *

8. Kërkesa për lejimin e udhëtimit zyrtar në Mbretërinë e Bashkuar

Kryesia, në lidhje me kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Nuk miratohet kërkesa e deputetit Armend Zemaj, me nr. 08/1987/Do-864, datë 25. 5. 2022, për lejimin e udhëtimit zyrtar në Londër (Mbretëri e Bashkuar), prej 22 deri më 25 qershor 2022.

9. *Kërkesa për mbulimin e shpenzimeve për udhëtimin zyrtar të realizuar në Tiranë (Shqipëri)*

Kryesia, në lidhje me kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

1. Deputetit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Arben Gashi, i mbulohen shpenzimet e udhëtimit dhe mëditjet lidhur me udhëtimin zyrtar në realizuar në Tiranë (Shqipëri), prej 20 deri më 21 maj 2022.
2. Deputetes së Kuvendit të Republikës së Kosovës, Ariana Musliu-Shoshi, i mbulohen shpenzimet e udhëtimit dhe mëditjet lidhur me udhëtimin zyrtar në realizuar në Tiranë (Shqipëri), më 20 maj 2022.

10. *Kërkesa për mbulimin e shpenzimeve për bileta aeroplani të anuluar, në lidhje me udhëtimet zyrtare*

Kryesia, në lidhje me kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Mbulohen shpenzimet e biletave të anuluar të aeroplanit për nënkryetaren e Kuvendit, Saranda Bogujevci, në lidhje me udhëtimet zyrtare të parapara të realizohen në Strasburg (Francë), prej 24 deri më 29 prill 2022, në shumën prej 202,01 euro dhe në Venecia (Itali), prej 19 deri më 22 prill 2022, në shumën prej 366,06 euro, si dhe për deputetin Gazmend Gjyshinca, në lidhje me udhëtimin zyrtar, të paraparë të realizohet në Bukuresht (Rumani), prej 24 deri më 27 maj 2022, në shumën prej 420,06 euro.

11. Kërkesa për lejimin e udhëtimit zyrtar në Suedi

Kryesia, në lidhje me kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

1. Deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës: Rrezarta Krasniqi, Haki Abazi dhe Fridon Lala, u lejohet udhëtimi zyrtar në Stokholm (Suedi), prej 14 deri më 16 qershor 2022.
2. Të gjitha shpenzimet e udhëtimit, të akomodimit dhe mëditjet për të lartshënuarit në pikën një (1) të këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

12. Kërkesa për lejimin e udhëtimit zyrtar në Strasburg (Francë)

Kryesia, në lidhje me kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

1. Deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës: Saranda Bogujevci, Arben Gashi dhe Enis Kervan, u lejohet udhëtimi zyrtar në Strasburg (Francë), prej 19 deri më 25 qershor 2022.
2. Të gjitha shpenzimet e udhëtimit, të akomodimit (nëse është e domosdoshme me tejkalim të shpenzimeve) dhe mëditjet për të lartshënuarit në pikën një (1) të këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Në fund, kryetari i Kuvendit, Glauk Konjufca, i njoftoi të pranishmit në lidhje me pjesëmarrjen e tij bashkë me anëtarët e Delegacionit të Kuvendit të Republikës së Kosovës në Asamblenë Parlamentare të Procesit të Bashkëpunimit të Evropës Juglindore në punimet e Sesionit Plenar dhe Takimin e Kryetarëve të kësaj asambleje, të mbajtur në Athinë (Greqi), prej 31 maj deri më 3 qershor 2022.

Kryetari e mbylli mbledhjen e Kryesisë në orën 11:02 minuta.

Glauk KONJUFCA

Kryetar i Kuvendit

Procesverbalin e hartoi:

Drejtoria për Çështje Plenare dhe Procedurale